



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS / AGRICULTURAL UNIVERSITY OF TIRANA

Rr. Pajsi Vodica, Kodër-Kaméz, Tiranë, Albania. / T: +35547200874 / E: info@ubt.edu.al / W: www.ubt.edu.al



MIRATOI
REKTORI

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU



RREGULLORE

MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT

Miratuar me Vendimin e Rektoratit të Universitetit Bujqësor të Tiranës

Nr.12 datë 16.02.2023

PJESA E PARË

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimitarise së Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit në UBT.

Neni 2

Baza ligjore

Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit, funksionon bazuar në:

- Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (neni 3, pika c; neni 95; neni 108; neni 109; neni 110, gëрма c; neni 111 dhe neni 113),
- Ligjin Nr. 43/2016 “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”
- Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës, miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 279, datë 28.07.2021,(neni 2, pika 4; neni 13; neni 33 deri tek neni 78).

Neni 3

Misioni dhe Vizioni

Misioni – Rritja e pjesëmarrjes në projekte kërkimore didaktike dhe zhvillimore si dhe studime strategjike në fushat që UBT mbulon, nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore, rritjes së interesit të stafit për pjesëmarrje në projekte dhe lehtësimit të procedurave të aplikimit dhe zbatimit të projekteve.

Vizioni – Universiteti Bujqësor i Tiranës është një partner prestigjioz në fushën kombëtare dhe ndërkombëtare për hartimin, menaxhimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore, zhvillimore dhe studimeve në fushat që mbulon.



PJESA E DYTË

Struktura organizative

Neni 4

Zyrat përbërëse të Drejtorisë

Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UBT-së. Struktura organike dhe stafi i Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit është si më poshtë:

- Drejtor i Drejtorisë
- Specialist i Drejtorisë së Projekteve dhe zhvillimit
- Përgjegjës i zyrës së PROGRAMeve ERASMUS DHE MOBILITETEVE,
- Përgjegjës i Projekteve IPA
- Përgjegjës i Projekteve COST
- Përgjegjës i Projekteve INTERREG IVCUBT
- Përgjegjës i Projekteve CEEPUS
- Përgjegjës i Projekteve HORIZON 2020
- Përgjegjës i Projekteve Kombëtare

Neni 5

Detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit

Funksionet bazë të punës së Drejtorisë së Projekteve përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Inkurajon partneritetin midis institucioneve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim pjesëmarjen në Projekte;
- Nxit dhe koordinon hartimin e propozimeve për projekte dhe trajnime, midis strukturave të ndryshme të UBT-së dhe institucioneve të tjera akademike ose kërkimore, në fushat që UBT mbulon;
- Nxit pjesëmarjen në programe kërkimi dhe zhvillimi të stafit akademik dhe atij ndihmës, e veçanërisht të kërkuesve të rinj dhe studentëve të UBT;
- Ofron informacion për personelin akademik dhe studentët e të gjitha niveleve, për mundësitë që ofrohen nëpërmjet programeve dhe projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare nga ente financuese, universitete dhe qendra të tjera kërkimore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- Lehtëson dhe ndihmon në kërkimin e partnerëve për realizimin e aplikimeve në programe dhe projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Informon personelin akademik dhe të gjithë të interesuarit e tjerë lidhur me procedurat e përgatitjes, aplikimit dhe zbatimit të projekteve dhe trajnimeve në fushat që UBT mbulon;



- Realizon rolin e Koordinatorit Institucional për programe të ndryshme të finançuara nga Bashkimi Evropian dhe ente të tjera finansuese;
- Këshillon personelin akademik në zgjidjen e problemeve që hasin gjatë zbatimit të projekteve;
- Bashkëpunon me kompani/organizata që kanë eksperiencë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve që mbështeten nga programe të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe enteve të tjera finansuese;
- Në bashkëpunim me strukturat e tjera të UBT-së, merr pjesë dhe organizon trajnime të ndryshme me qëllim rritjen e kualifikimit të stafit të UBT-së në fushen e shkrimit te projekteve dhe aspekte te menaxhimit te tyre;
- Përgatit, administron dhe përditëson, në bashkëpunim me Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, bazën e të dhënave dhe statistikat përkatëse të projekteve të realizuara në UBT;
- Ndiham në përgatitjen e raporteve vjetore për pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Përgatit formularët e projektit dhe thirrjen për projektet me financim te brendshëm nga ana e UBT-së dhe merr pjesë në procesin përzgjedhës,sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren përkatëse të menaxhimit të projekteve;
- Pajis me modelin e dokumentacionit që disponon të gjitha strukturat e interesuara në UBT;
- Organizon dhe menaxhon thirrjet për projekte të finançuara me fondet e UBT-së, në bashkëpunim me Zëvendësrektorin për Shkencën dhe Projektet dhe Zëvendësrektorin për marrdhëni me publikun;
- Organizon së paku një herë në 6 muaj aktivite informative dhe shkencore,mbi pritshmeritë dhe rezultatet e projekteve të fituara dhe përfunduara në UBT,për Programin Erasmus, CEEPUS, IPA, INTERREG, Cost si edhe peë projektet e finançuara nga AKKSHI.

Neni 6

Detyrat dhe funksionet e Drejtorit të Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit

Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit emërohet nga Rektori i UBT-së dhe përgjigjet përpala tij. Detyrat dhe funksionet kryesore të drejtorit të drejtorisë, përfshijnë, por nuk kufizohen,si me poshtë:

- Drejton dhe organizon punën e drejtorisë dhe kontrollon kryerjen e detyrave nga seçili punonjës i saj;



- Nxit partneritetin midis UBT-së me institucione të tjera në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në funksion të misionit të drejtorisë;
- Bashkëpunon me Zv. Rektorin për Shkencën dhe Projektet ne lidhje me përcaktimin e prioriteteve te veprimitarisë së Drejtorisë dhe zyrave brenda saj;
- Informon në mënyrë periodike Zëvendësrektorin për Shkencën dhe Projektet, si dhe Rektorin e UBT-së për ecurinë e aplikimit dhe zhvillimit të projekteve. Në fund të cdo viti përgatit raportin e ecurisë së aktivitetit të zyrës, projektet e implementuara, problematikat e hasura gjate aplikimit dhe implementimit te tyre, etj në funksion të analizës shkencore në nivel Universiteti.
- Përgatit planin e punës se zyrës së projektit dhe sigurohet që cdo veprim do t'i përbahet të gjitha ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve në fuqi, si dhe të krijojë një mjedis të sigurt pune.
- Sigurohet që të gjithë punonjësите zyrës së projektit, tëkuqtojnë rolet e tyre dhe të pranojnë përgjegjësitë e tyre.
- Ndjek progresin e realizimit të aktiviteteve të cdo punonjësitë zyrës së projektit që drejton, dhe sigurohet për metodat e punës të përdorura, përshtatshmërinë dhe vlefshmërinë e rezultateve.
- Organizon dhe menaxhon në mënyrë efektive burimet njerëzore në funksion të realizimit të objektivave të zyrës se projekteve.
- Raporton pranë rektoratit (zv/rektore se shkences dhe projekteve) në mënyrë periodike mbi ecurinë e zyrës së projekteve dhe zhvillimit.
- Merr masat e nevojshme për publikimin dhe sigurimin e shikueshmërisë së rezultateve të arritura nga aktiviteti i zyrës së projekteve dhe zhvillimit në platformat e publikimit të përcaktuara nga UBT-ja.
- Ndihamon stafin e zyrës së projekteve në organizimin e konsultave lidhur me aplikimin për projekte dhe zbatimin e tyre;
- Drejton punën për hartimin e dokumenteve të rëndësishëm, në funksion të dokumentacionit të aplikimit dhe pjesëmarrjes në projekte të personelit të UBT-së, në bashkëpunim me stafin e zyrës së projekteve dhe ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë,
- Koordinon aktivitetet që kanë për qëllim forcimin e bashkëpunimit shkencor brenda njësive të UBT-së, si dhe të vetë UBT-së me institucione analoge brenda dhe jashtë vendit.



Neni 7

Detyrat dhe funksionet e Përgjegjësit të Zyrave të Programeve të veçanta

Përgjegjësi i zyrave të programit të veçantë emërohet nga Rektori i UBT-sëdhe e zhvillon veprimtarinë e tij në kuadrin e Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit. Airaporton para drejtorit të Drejtorisë, dhe ka detyra që përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Ndjek në mënyrë të vazhdueshme thirrjet e programeve përkatëse për financim projektesh;
- Njofton të gjithë personat e interesuar për thirrjet për projekte pasi merr miratimin e Drejtorit të Drejtorisë dhe Rektoratit të UBT-së;
- Nxit dhe mbështet përgatitjen e projekteve në programin që mbulon;
- Ndjek dhe mbështet zbatimin e projekteve të financuar në programin përkatës;
- Organizon konsulta lidhur me aplikimin për projekte dhe zbatimin e tyre në programin që mbulon;
- Krijon dhe mban kontakte me Pikën Kombëtare të Kontaktit (NCP) për programin respektiv;
- Propozon, në rast se është e domosdoshme, ndihmë të specializuar në hartimin e projekt-propozimeve për programin që mbulon duke e argumentuar këtë;
- Ndjek dhe mbështet aplikimet që bëhen nga stafi i UBT-së për projekte;
- Kërkon informacion nga drejtuesit e projekteve për zbatimin e tyre në mënyrë periodike dhe vë në dijeni Drejtorin e Drejtorisë për ecurinë e këtyre projekteve;
- Raporton periodikisht pranë Drejtorit të Drejtorisë për ecurinë e aktiviteteve të kryera në funksion të realizimit të detyrave të tij/saj;
- Harton material përbledhës vjetor për projektet e financaura në programin përkatës dhe informon Drejtorin e Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit;
- Ndihamon në hartimin e raporteve të Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit;
- Bashkëpunon në organizimin e aktiviteteve të Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit;

Neni 8

Detyrat dhe funksionet e Specialistit të Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit

Specialisti i Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit emërohet nga Rektori i UBT-së. Ai/ajo bashkëpunon me Drejtorin e Drejtorisë dhe përgjegjësit e zyrave të projekteve të veçanta në realizimin e objektivave dhe të detyrave të tyre. Funksionet bazë të Specialistit të Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit përfshijnë, por nuk kufizohen në:



- Bashkëpunon me Drejtorin e Drejtorisë dhe Përgjegjësit e Zyrave të programeve, në realizimin e objektivave dhe të detyrave parësore të drejtorisë;
- Administron të gjithë procesin e grumbullimit të aplikimeve të cfarëdo lloj projekti që aplikon stafi i UBT-së, dhe pas konfirmimit të Drejtorit të Drejtorisë i dërgon ato për firmë tek Zëvendësrektoripër Shkencën dhe Projektet;
- Harton dhe shpërndan njoftimet për shpalljen e thirrjeve për projekte, në bashkëpunim me Përgjegjësit e Zyrave të programeve të veçanta;
- Administron raportimet periodike (çdo muaj) të Përgjegjësve të Zyrave pranë Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit;
- Njofton për mbledhjet e Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit, sidhe përgatit reportin e mbledhjes.
- Ndihmon në përgatitjen e raportimeve periodike të Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit;
- Bashkëpunon dhe ndihmon në përgatitjen dhe administrimin e bazës së të dhënavës dhe statistikave përkatëse të projekteve dhe programeve që zbatohen në UBT;
- Zbaton detyrat e dhëna nga Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit në funksion të detyrave të tij;
- Bashkëpunon dhe ndihmon në përgatitjen e aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit, në përgatitjen e statistikave, raporteve, fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera informuese, në funksion të detyrave të Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit në UBT;
- Bashkëpunon dhe ndihmon në informimin e punonjësve akademikë dhe të gjithë të interesuarve të tjerë, lidhur me procedurat e aplikimit për projekte.

PJESA E TRETË

Dokumentacioni që kërkon dhe mban Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit

Neni 9

Drejtoria e Projekteve dhe zhvillimit, në arkivin e saj, mban dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nëligjore që burojnë në zbatim të tij Statutin e UBT-së, miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 279, datë 28.07.2021.



2. Dokumentacionin bazë të rregullimit të aplikimit për projekte dhe zbatimit të tyre në UBT.
3. Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit.
4. Dosjen e plotë të projekt-propozimeve të dërgura, si dhe dosjen e plotë të projekteve të fituara nga cdo individ nën siglën e Universitetit Bujqesor të Tiranës.
5. Raportet periodike dhe përfundimtare të projekteve të zbatuara në UBT.
6. Materialet përmbledhëse të vlerësimit të projekteve të zbatuara në UBT.
7. Raportimet periodike të përgjegjësve të zyrave pranë Drejtorisë së Projekteve dhe Zhvillimit.
8. Analizat dhe raportet e vlerësimit institucional të brendshëm dhe të jashtëm.

PJESA E KATËRT

Ndryshimi, hyrja në fuqi dhe zbatimi

Neni 10

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj në Rektorat.
2. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje Zv. Rektori për Shkencën dhe Projektet dhe Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit si dhe të gjitha njësitë përbërëse të UBT-së.
3. Kjo rregullore zbatohet në mënyrë të vazhdueshme dhe për një kohë të pacaktuar nga strukturat e ngarkuara, menjëherë pas miratimit të saj.
4. Të drejtën e ndryshimeve në këtë rregullore e ka vetëm Rektorati, me propozimet përkatëse të Drejtorisë dhe në përputhje me aktet e tjera rregullatore të UBT-së .

